RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

KOMUNIKATË

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, mbajti mbledhjen e radhës sipas agjendës së përcaktuar në rend dite.

Sot, me datë 17 korrik 2026, në mbledhjen e Bordit të RTK-së, pas përfundimit të procedurës së konkursit publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, përfshirë procesin e intervistimit dhe vlerësimit të kandidatëve, Bordi zhvilloi procesin e votimit për përzgjedhjen e kandidatit.

Pas votimit unanim nga të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së, për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së është emëruar Zana Spahiu.

Bordi i RTK-së vlerëson se procesi i përzgjedhjes është zhvilluar në mënyrë transparente, profesionale dhe në përputhje me parimet e meritës dhe mundësive të barabarta, kurse vendimi për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së do të publikohet në përputhje me procedurat në fuqi.

Bordi i RTK-së i uron suksese Drejtores së Përgjithshme të sapozgjedhur dhe shpreh përkushtimin për vazhdimin e punës në funksion të zhvillimit dhe forcimit të transmetuesit publik.